

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
”DEJVIS KLISI 1965” SHPK

Sot, më datë 01/09/2022, u paraqit personalisht:

- **Z. ROMINO ALLAMANI**, i datëlindjes 22/01/1997, shtetas Shqiptar, lindur ne Milot, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr BC0019513 dhe Nr. Personal J70122030M.

I cili përpiloj këte akt themelimi të shoqërisë tregtare “DEJVIS B.A. - 1965” SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1
Forma Ligjore

Të themeloj Shoqerinë Tregtare "**DEJVIS KLISI 1965**" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "**DEJVIS KLISI 1965**" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2
Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3
Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "**DEJVIS KLISI 1965**" SH.P.K dhe me emrin tregtar **DEJVIS KLISI 1965**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4
Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Prodhim, tregtim lende inerte, rere, zhavor, çimeto dhe te gjitha lendet e tjera qe nevojiten per ndertimet e lejura nga ligji

NENI 5
Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Milot, në adresën: **Milot, Rruga e kombit, km 2, Zk nr.2693, me pasuri nr.1/62**



Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 200.000 (dyqind mijë leke) dhe zotërohet nga ortaket themelues:

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: Lekë 200.000 dyqind mijë leke)

Vlera e paguar: 200.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku themelues.

NENI 7

Ortaket themeluese Shoqërisë Tregtare " **DEJVIS KLISI 1965**" SH.P.K zotërojne kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

| | |
|--------------------------|-----------------------------------|
| Ortaku themelues : | ROMINO ALLAMANI |
| Numri i kuotave : | 1 |
| Numri i pjeseve : | 1 |
| Pjesemarrja ne Shoqeri : | 100,00 % |
| Lloji i kontributit: | Ne para |
| Vlera e kontributit | 200,000 (dyqind mijë) leke |

Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas rregjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e rregjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.

Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne kete Statut.

NENI 8

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9

Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratoret e shoqerise do te jene :



- **Z. ROMINO ALLAMANI**, i datëlindjes 22/01/1997, shtetas Shqiptar, lindur ne Milot, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr BC0019513 dhe Nr. Personal J70122030M.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues, u gjet sipas vullnit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaket janë njohes te gjuhes shqipe.

ORTAKU THEMELUES

ROMINO ALLAMANI

Romino

Allamani